

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

Pml.Kzz 7/2015

(P. Nr. 410/2013 Gjykata Themelore në Prizren)

(PN 1. 2566/2014 Gjykata e Apelit)

Data:

23 janar 2015

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta (kryetare e kolegjit), Gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti (gjyqtar raportues) dhe Gjyqtari i Gjykatës Supreme Sali Toplica si anëtarë të kolegjit, në prani të Zyrtares ligjore të EULEX-it Kerry Kirsten Moyes si Procesmbajtëse, në lëndën penale me numër P. Nr. 410/2013 të Gjykatës Themelore në Prizren, kundër;

MB, në paraburgim prej 13 dhjetorit 2012;

et al

I akuzuar për veprat penale në vijim:

Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafëve 1, 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së);

Kontrabandimi me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafëve 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPK-së;

Pastrim i parave në kundërshtim të nenit 32 të *Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i 3 shtatorit 2010, i nxjerrë më 18 tetor 2010*, dhe gjersa i zbatueshëm, nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të ngjashme, e miratuar më 5 shkurt 2004 (siç është ndryshuar);

Duke vepruar lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 12 janar 2015 nga avokati mbrojtës Osman Zajmi, në emër të pandehurit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren P. Nr. 410/2013 të datës 11 dhjetor 2014, mbi vazhdimin e masës së paraburgimit për këtë të pandehur (dhe të bashkakuzuarit) për dy (2) muaj deri më 12 shkurt 2015, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN 1. 2566/2014 të datës 27 dhjetor 2014, mbi refuzimin e ankesës së të pandehurit;

Pas shqyrtimit të përgjigjes në kërkesë nga Prokurori i Shtetit KMLP.II. – ZZZK. II. Nr. 3/2015 të paraqitur më 21 janar 2015;

Pas këshillimit dhe votimit më 23 janar 2015;

Sipas neneve 418 dhe 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)

lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur më 12 janar 2015 nga avokati mbrojtës Osman Zajmi, në emër të pandehurit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren P. Nr. 410/2013 të datës 11 dhjetor 2014, mbi vazhdimin e masës së paraburgimit për këtë të pandehur edhe për dy (2) muaj deri më 12 shkurt 2015, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN 1. 2566/2014 të datës 27 dhjetor 2014 mbi refuzimin e ankesës së të pandehurit, refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIM

1. Historia e procedurës

1.1. Më 11 korrik 2011, Prokurori ka lëshuar aktvendimin mbi fillimin e hetimit dhe më 3 dhjetor 2012, Prokurori ka lëshuar aktvendimin mbi zgjerimin e hetimit për të pandehurin.

1.2. I pandehuri është arrestuar më 13 dhjetor 2012 dhe gjyqtari i procedurës paraprake në të njëjtën ditë ka caktuar paraburgimin kundër tij. Masa kundër të pandehurit është vazhduar disa herë dhe të gjitha ankesat e paraqitura janë refuzuar si të pabazuara nga Gjykata e Apelit. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar, dhe që nga 11 dhjetori 2014 janë mbajtur 14 seanca të gjyqimit.

1.3. Më 11 dhjetor 2014, kryetari i trupit gjykues ka vazhduar më tutje masën e paraburgimit kundër të pandehurit (dhe të bashkakuzuarit) edhe për dy (2) muaj deri më 12 shkurt 2015. Ankesë kundër këtij aktvendimi është paraqitur nga avokati mbrojtës Osman Zajmi në emër të pandehurit më 17 dhjetor 2014, dhe me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të datës 27 dhjetor 2014, është refuzuar si e pabazuar.

1.4. Më 12 janar 2015, avokati mbrojtës Osman Zajmi, në emër të pandehurit ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtyre dy aktvendimeve. Më 21 janar 2015, Prokurori ka paraqitur përgjigjen.

2. Parashtrësit e palëve

2.1. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të dispozitave të procedurës penale, shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe shkelje të dispozitave të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai propozon që masa e paraburgimit të zëvendësohet me një masë më të butë të arrestit shtëpiak. Hetimet kanë përfunduar dhe dëshmitarët janë dëgjuar. I pandehuri është deklaruar i pafajshëm dhe nuk ka asnjë provë që tregon se ai ka përfituar dobi të konsiderueshme pasurore. Ai ka gjendje të dobët ekonomike, është i martuar dhe ka dy fëmijë dhe prindërit e tij janë të sëmurë rëndë. Ai gjithashtu ka premtuar se do të përgjigjet në ftesa, dhe identiteti i tij është i njohur dhe ka adresë të saktë të vendbanimit. I pandehuri ka qenë në paraburgim për më tepër se dy vite që është në shkelje të nenit 185 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2.2. Prokurori i Shtetit i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzojë kërkesë si të pabazuar, dhe aktvendimet e kontestuara t'i vërtetojë në tërësi. Prokurori vëren se avokati mbrojtës përsërit të njëjtat argumente të cilat i ka paraqitur në Gjykatën Themelore në Prizren dhe në ankesën e tij më të fundit. Kundërshtimi i fakteve dhe provave të lëndës nuk mund të jenë objekt i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe janë në shqyrtim gjatë shqyrtimit gjyqësor. Avokati mbrojtës në kërkesën e tij gjithashtu i referohet dispozitave të gabuara të KPP-së; Neni 384 paragrafi 1.1.2 i referohet përjashtimit të gjyqtarit nga pjesëmarrja në shqyrtim gjyqësor, dhe neni 384 paragrafi 1.12 (nëse avokati mbrojtës ka dashur ta përmend këtë dispozitë në vend të asaj) vlen për aktgjykimet dhe ankesat kundër aktgjykimeve, dhe jo për aktvendimet. Dispozita e saktë që rregullon përmbajtjen e aktvendimit mbi vazhdimin e paraburgimit është neni 189 paragrafi 1i KPP-së. Nuk vlejné as kufizimet kohore të nenit 190 pasi që rasti është në fazën pas aktakuzës. Aktvendimet e kundërshtuara janë arsyetuar mirë, avokati mbrojtës nuk ofron asnjë argument i cili sugjeron se Gjykata Themelore nuk është duke vazhduar me shqyrtimin gjyqësor në mënyrë urgjente, dhe kërkesa është e pambështetur lidhur me shkeljet e pretenduara të drejtave të njeriut të të pandehurit.

3. Gjetjet e kolegjit

3.1. Kolegji njëzëri ka vendosur që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të konsiderohet si “rast në proces” sipas nenit 1.A të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të UELEX-it në Kosovë, dhe prandaj gjyqtarët e UELEX-it kanë kompetenca në këtë lëndë. Kolegji ka vendosur me shumicë votash se gjyqtarja vendore duhet të jetë kryetare e kolegjit¹. Mbi këtë bazë, Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta vepron si kryetare e kolegjit.

3.2. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës dhe përgjigja e e paraqitur nga Prokurori i Shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura brenda afatit të përcaktuar.

3.3. Gjykata Supreme pajtohet me Prokurorin e Shtetit se përmbajtja e kërkesës është pak më tepër se përsëritje e parashtrësive të mëparshme nga mbrojtja, të cilat të gjitha janë marrë parasysh dhe shqyrtuar edhe nga Gjykata Themelore edhe nga Gjykata e Apelit. Kolegji gjen

¹ Mendimi i ndarë i gjyqtarit Timo Vuojolahti i është bashkangjitur këtij aktvendimi.

se të dy gjykatat ka lëshuar aktvendime të cilat janë të arsyetuara mirë dhe në pajtim të plotë me ligjin e procedurës penale. Avokati mbrojtës nuk ofron asnjë argument apo fakt të ri që do ta shtynte Gjykatën Supreme të konstatojë ndryshe nga ajo se masa e paraburgimit është tërësisht e arsyetuar dhe se asnjë masë tjetër më e butë nuk do të mjaftonte për të eliminuar rreziqet. Gjithashtu, kolegji është hutuar nga nenet e cituara nga avokati mbrojtës në kërkesën e tij, pasi që ato nuk janë të përshtatshme për rrethanat e të pandehurit, e as nuk është paraqitur ndonjë argument për t'i mbështetur ato. Kolegji përfundon se ato janë cituar gabimisht nga avokati mbrojtës.

3.4. Në përfundim, Gjykata Supreme gjen se të dy gjykatat i kanë kushtuar konsideratë të plotë rrethanave të të pandehurit si dhe natyrës së veprave të pretenduara. Më tutje, tani gjykimi është në vazhdim. Prandaj, Gjykata Supreme nuk gjen asnjë shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, ligjit penal, Kushtetutës së Republikës së Kosovës apo Konventave ndërkombëtare, dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e refuzon si të pabazuar.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar

Kryetare e kolegjit

Nesrin Lushta

Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Procesmbajtëse

Kerry Kirsten Moyes

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Timo Vuojolahti

Gjyqtar i EULEX-it

Sali Toplica

Gjyqtar i Gjykatës Supreme